

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 760 Rep.

Nr. 280 Kol.



KONTRATË SHITJE KUOTE

Sot, më datë 28.01.2020 (dy mijë e njëzetë) përpara meje Noterit Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli ne Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13, u paraqitën palët e mëposhtme:

SHITESI: Shoqeria "PAKTI" Sh.P.K., një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L26912401G, me seli ne Diber, Bulqize, Shqiperi, perfaqesuar nga Z. Oltjan Kala, shtetas shqiptar, lindur me 30.03.1989 ne Bulqize, Diber, mbajtes i leternjoftimit me nr. 027634047 dhe nr. personal I90330016B, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar; *ne vijim referuar si "PAKTI Sh.P.K."*
dhe

Z. Petrit Doda, shtetas shqiptar, lindur me 01.03.1961 ne Diber e banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 034856201, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar,

ne vijim referuar si "Shitësit"

si edhe

BLERESI: Shoqeria "EGI-K" Sh.P.K., një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT K77424401L, me seli ne Lagja Qyteti i ri, Pallat 5-katesh, Kati 5, Shk. 1, Bulqize, Shqiperi, perfaqesuar nga Administratori Z. Eduart Keta, shtetas shqiptar, i biri i Hazisit, lindur me 18.10.1968 ne Bulqize dhe banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. Personal G81018063L, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, *ne vijim referuar si "EGI-K" Sh.p.k;*

dhe

Z. Edison Doda, shtetas shqiptar, lindur me 10.09.1990 ne Peshkopi, Diber e banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes me nr. BE2103315 dhe nr. personal J00910012R, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

ne vijim referuar si "Blerësit"

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- A. Shoqëria "MARSIAN SERVICE" Sh.P.K. (ne vijim "Shoqeria"), shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me Numer Unik Identifikimi NUIS K92411010F, me seli ne Bulqize, Lagjja Gjeologu, me kapital themeltar prej 100.000 (njëqind mijë) Lekë, dhe sikurse rezulton nga regjistrimet në Regjistrin Tregtar Shitësi "PAKTI" Sh.p.k zotëron 5% të kuotave të kapitalit dhe Shitesi Petrit Doda zotëron 10% te kuotave te kapitalit te shoqerise;
- B. Shitësi "PAKTI" Sh.p.k i ka njoftuar Blerësit "EGI-K" sh.p.k ofertën e tij për shitjen e 1% (nje) perqind te kuotave të kapitalit themeltar te Shoqerise "MARSIAN SERVICE" Sh.p.k, dhe Blerësi "EGI-K" sh.p.k ka pranuar të blejë 1% te kuotave te zotëruara dhe të ofruara nga Shitësi "PAKTI" SH.P.K, në Shoqërine "MARSIAN SERVICE" Sh.p.k;
- C. Shitësi z. Petrit Doda i ka njoftuar Blerësit Z. Edison Doda ofertën e tij për shitjen e 10% (dhjete perqind) te kuotave të kapitalit themeltar te Shoqerise "MARSIAN SERVICE" Sh.p.k, dhe Blerësi Edison Doda ka pranuar të blejë 10% te kuotave te zotëruara dhe të ofruara nga Shitësi Petrit Doda, në Shoqërine "MARSIAN SERVICE" Sh.p.k;
- D. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe pas miratimit përkatës sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, bashkëlidhur, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

- 1.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi "PAKTI" Sh.p.k i shet Blerësit "EGI-K" Sh.p.k, gjithsej **1% (nje)** perqind te kuotave të kapitalit themeltar te Shoqerise dhe Blerësi "EGI-K" Sh.p.k blen nga Shitësi gjithsej **1% (nje)** perqind te kuotave të kapitalit themeltar te Shoqerise, Ndersa Shitesi Petrit Doda i shet bleresit Edison Doda gjithsej **10% (dhjete perqind)** te kuotave te kapitalit te shoqerise dhe bleresi Edison Doda blen nga Shitesi Petrit Doda gjithsej 10% te kuotave te kapitalit te Shoqerise.

Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimi i shitjes së 1 % (nje) te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe shitesi PAKTI Sh.p.k i shet bleresit "EGI-K" Sh.p.k është 1.000 LEKE (nje mije leke).
- 2.2 Çmimi i shitjes së 10 % (dhjete) te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe shitesi Petrit Doda i shet bleresit Edison Doda është 10.000 LEKE (dhjete mije leke).
- 2.3 Çmimi i shitjes së kuotave jane paguar plotësisht tek Shitësit nga Blerësit jashtë zyres së Noterisë dhe përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Neni 3 Deklarimet dhe garancite

- 3.1 Shitësit deklarojne dhe vertetojne se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ata zotërojnë kuotat që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe kane të drejtën për t'i transferuar këto kuota dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave janë Shitësit. Shitësit përgjigjen për detyrimet që Shoqëria mund të ketë ndaj të tretëve përfshirë detyrimet tatimore përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate.



3.2. Blerësit deklarojnë dhe vërtetojnë se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Blerësit kanë tagra të plota për të pranuar kuotat nga Shitësit sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave janë Blerësit.

Neni 4 Transferimi i të drejtave mbi kuotat

4.1. Pronësia mbi kuotat e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësit te Blerësit menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Blerësve do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.

4.2. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zoterimit të kapitalit themeltar të Shoqërisë do të jetë si vijon:

- *Z. Petrit Doda pasi shet të gjithë pjeset e kapitalit të zoteruara prej tij largohet si ortak nga shoqëria "MARSIAN SERVICE" Sh.p.k;*
- *Z. Edison Doda bëhet zotëruar i 10% të kuotave të kapitalit të shoqërisë;*
- *NDREGJONI Sh.P.K. mbetet zotëruar e 5% të kuotave të kapitalit;*
- *RUNJA Sh.P.K. mbetet zotëruar e 46% të kuotave të kapitalit;*
- *EGI-K Sh.P.K. bëhet zotëruar e 35% të kuotave të kapitalit;*
- *PAKTI Sh.P.K. bëhet zotëruar e 4% të kuotave të kapitalit*

4.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësit gëzojnë të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat e zoteruara në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5 Të ndryshme

5.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzoleve apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

5.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 131/2015, Ligjit 9901/2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5.4. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën Shqipe në 4 (kater) origjinale.

Kjo Kontratë pasi iu lexua Palëve me zë të lartë e të qartë, nga unë Noteri, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve në praninë time dhe unë, Noteri, e vërtetoj atë sipas ligjit dhe për gjithë efektet që passjell.

SHITËSI

PAKTI Sh.P.K.

Perfaqesuar nga Administratori

Oliver Kala

Z. Petrit Doda

Petrit Doda

BLERËSI

EGI- K Sh.P.K.

Perfaqesuar nga Administratori



Z. Edison DODA

Edison Doda

NOTERI
JULIAN ZHELEGU

Julian Zhegu



**VENDIM
I ORTAKEVE TE SHOQERISE
"PAKTI" Sh.P.K.**

Shoqëria "PAKTI" Sh.P.K. është person juridik shqiptar, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L26912401G.

Sot me date 23 . 01 .2020 jane mbledhur ortaket qe perfaqesojne 100% (njqind per qind) te kapitalit te shoqerise,

VENDOSEN:

- 1) Te miratojne shitjen e 1% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise "MARSIAN SERVICE" Sh.P.K. me NIPT K92411010F, ne favor te blesit Shoqeria "EGI-G" Sh.p.k.
- 2) Te autorizojë administratorin e shoqerise per nenshkrimin e kontrates se shitblerjes se kuotave, duke pasur te gjithë tagret, kompetencat e pushtetet e plota e te pakufizuara, per te vendosur vete ne lidhje me çdo dhe te gjithë kushtet dhe afatet e ketyre marreveshjeve.

Lexuar, aprovuar e nenshkruar nga Ortaket e shoqerise:

ORTAKET

RUNJA SHPK

Perfaqesuar nga Administratori

Petrit Doda



EDUART KETA

EDUART KETA





VENDIM
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
"EGI-K" Sh.P.K.

Shoqëria "EGI-K" Sh.P.K. është person juridik shqiptar, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT K77424401L.

Sot me date 28 . 01 .2020 ortakut i vetem i Shoqerise,

VENDOSI:

- 1) Te miratoje blerjen e 1% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise "MARSIAN SERVICE" Sh.P.K. me NIPT K92411010F, te zoteruara nga ortakut tjetër i saj PAKTI Sh.P.K.
- 2) Te autorizojë administratorin e Shoqerise per nenshkrimin e kontrates se shitblerjes se kuotave, duke pasur te gjithë tagret, kompetencat e pushtetit e plota e te pakufizuara, per te vendosur vete ne lidhje me çdo dhe te gjithë kushtet dhe afatet e ketyre marreveshjeve.

Lexuar, aprovuar e nenshkruar nga Ortakut i Vetem

ORTAKUT I VETEM

Eduart Keta



VENDIM
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE
"MARSIAN SERVICE" Sh.P.K.

Shoqëria "MARSIAN SERVICE" Sh.P.K. është person juridik shqiptar, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT K92411010F.

Sot me date 28. 01. 2020 u mbledh Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, ne mungese te nje akti formal thirrjeje, por me prezencen dhe miratimin e te gjithe ortakeve qe perfaqesojne 100% te kuotave te kapitalit te Shoqerise, te cilet vendosin dhe bien dakord te vijojne me shqyrtimin e çeshtjeve te meposhtme te rendit te dites dhe marrjen e vendimeve te vlefshme ne lidhje me to:

1. Miratimi i shitjes se 1% te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe zoterohet nga ortaku "PAKTI" Sh.P.K. ne favor te ortakut tjetër te Shoqerise EGI-K Sh.P.K.;
2. Miratimi i shitjes se 10% te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe zoterohet nga ortaku Petrit Doda ne favor te Z. Edison Doda;
3. Te tjera, eventuale.

Pasi shqyrtuan çeshtjet e mesiperme te rendit te dites, në bazë të Ligjit 9901/2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me unanimitet:

VENDOSI:

1. Te miratoje shitjen e 1% te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe zoterohet nga ortaku "PAKTI" Sh.P.K. ne favor te ortakut tjetër te Shoqerise EGI-K Sh.P.K.;
2. Te miratoje shitjen e 10% te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe zoterohet nga ortaku Petrit Doda ne favor te Z. Edison Doda;
- 1) Te autorizojë administratorin e shoqerise te lidhi kontratat / marreveshjet perkatese pa asnje kufizim kohor dhe pa asnje kufizim ne lidhje me kushtet dhe afatet per te cilat keto pale mund te bien dakord.
- 2) Te kryhen depozitimet dhe regjistrimet perkatese ne perputhje me ligjet ne fuqi duke autorizuar per kete qellim Z. JOZEF RELAJ, qe te regjistroje kete vendim si dhe kontraten perkatese te shitjes se kuotave prane QKB.

Lexuar, aprovuar e nenshkruar nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve:

NDREGJONI Sh.P.K.
Perfaqesuar nga Administratori
[Signature]

RUNJA Sh.P.K.
Perfaqesuar nga Administratori
[Signature]



EGI-K Sh.P.K.
Perfaqesuar nga Administratori
[Signature]

Petrit Doda
[Signature]



PAKTI Sh.p.k
Perfaqesuar nga
[Signature]

